



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 430/15 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

**VENDIM**  
**Nr.200, datë 23.12.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 80, DATË 02.07.2019, NË**  
**INSTITUCIONIN QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 80, datë 02.07.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Qendra Kombëtare e Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin nr. 29, datë 19.04.2019, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Biznesit”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Qendra Kombëtare e Biznesit.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmëruar për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 80, datë 02.07.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatoj se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, për njësinë përgjegjëse, DAP, unifikimi i kategorizimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë, *(në rastin konkret për pozicionet e punës “Drejtor Drejtorie” dhe “Përgjegjës Sektori”)*, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatoj se, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3965/1 prot., datë 10.07.2019, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 426/15 prot., datë 12.07.2019, ka sqaruar se, në kuadër të projektit IPA 2014, “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, DAP në bashkëpunim me grupin e ekspertëve të projektit, prej muajit tetor 2018, ka filluar punën për zbatimin e këtij projekti, ku dy ndër aktivitetet kryesore të tij lidhen me zhvillimin e sistemit të ri të pagave të nëpunësve civilë dhe reformimin e sistemit të pagave të administratës publike në tërësi, si dhe rishikimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës dhe përshkrimeve të punës, hartimin e një katalogu të pozicioneve të punës, etj.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për institucionin e mbikëqyrur, t’i dërgojë zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë formularin e vlerësimit të punës për Drejtorin e Përgjithshëm të institucionit, i cili është anëtar i TND-së, me qëllim që të përmbillet procesi i vlerësimit të rezultateve në punë.

Sa i takon zbatimin të kësaj detyre, me shkresën nr. 5852/4 prot., datë 17.07.2019, me objekt: “Mbi zbatimin e vendimit nr. 80, datë 02.07.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Qendra Kombëtare e Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë””, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 430/13 prot., datë 18.07.2019, Qendra Kombëtare e Biznesit ka bërë me dije Komisionerin se, formulari i vlerësimit të punës së Drejtorit të Përgjithshëm, anëtar i TND-së, i është dërguar Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 9512 prot., datë 12.07.2019, për të vijuar më tej procedura e vlerësimit nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.

Njëkohësisht, pas përfundimit të procesit të njohjes së çdo specialisti me përshkrimin e punës të pozicionit ku ai është emëruar dhe formalizimit të këtij procesi me nënshkrimin e përshkrimit të punës nga nëpunësi civil dhe eprori direkt, me shkresën nr. 9516 prot., datë

12.07.2019, institucioni i mbikëqyrur ka finalizuar këtë proces, me dërgimin për nënshkrim të formularëve të përshkrimit të punës tek Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimi të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 80, datë 02.07.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Qendra Kombëtare e Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Qendra Kombëtare e Biznesit, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr.80, datë 02.07.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**